




KOLEGJI UNIVERSTAR "BEDËR"

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në *Shkenca Islame*

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja
2. Msc. Rudina Çinari
3. Msc. Xhorxhina Seferi
4. Msc. Hysni Skura
5. Baktyiar Makkambaev

- Kryetar 
- Anëtar 
- Anëtar 
- Anëtar 
- Përfaqësues i studentëve 

Janar/2024



PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| MENDIMI I DREJTUESIT TË NJËSISË..... | 3 |
| PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM | 4 |
| PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM | 5 |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE | 6 |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR..... | 9 |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE..... | 33 |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR..... | 41 |
| PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË SHKENCA ISLAME..... | 48 |
| SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT | 52 |
| SHTOJCA TABELAT PËRMBLEDHËSE..... | 53 |



 Faqja 2   

MENDIMI I DREJTUESIT TË NJËSISË¹



¹ Evidenca nr. 1 Mendimi i dekanit

[Handwritten signatures]

Faqja 3

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit "Bachelor" në *Shkenca islame* parashtron arsimim për të gjithë ata studentë, që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat në fushën e *Shkencave islame*. Ky cikël studimesh zgjat tre vite dhe programi është projektuar i tillë që t'u ofrojë studentëve një horizont intelektual, duke parashtruar një shumëlojshmëri konceptuale në fushën e *Shkencave slame*.

Ky program i ciklit të parë "Bachelor" synon të ndihmojë studentët në fitimin e aftësive të leximit dhe vlerësimit të burimeve klasike dhe bashkëkohore të *Shkencave islame*. Qëllimi i kryesor i programit të studimit "Bachelor" në *Shkenca islame* është formimi i një individi, që përbledh në vetvete cilësitet e aftësitet e leximit dhe perceptimit të burimeve themelore të shkencave islame, që ndjek nga afër nevojat dhe ecurinë e informacionit në këtë fushë, kërkues, aktiv, bashkëpunues, i integruar në shoqëri, si dhe zotërues i cilësive etike, estetike, kulturore dhe profesionale.

Studentët që ndjekin këtë program studimi janë aktivë dhe të gatshëm për të bashkëpunuar, janë të integruar në shoqëri, zoterojnë vlerat universale së bashku me ato fetare dhe përfaqësojnë profesionin e tyre në mënyrën më dinjitoze lidhur me kulturën dhe traditën shqiptare, si dhe atë evropiane, në përputhje me zhvillimet e shekullit XXI.

Programi "Bachelor" në *Shkenca islame* synon të ndihmojë studentët në fitimin e aftësive të leximit dhe vlerësimit të burimeve klasike e bashkëkohore në *Shkencat islame*; edukimin e studentëve me qëllim përvetësimin e njohurive të thella në lidhje me aspektet fetare e sociale në harmoni me fushën e studimit të *Shkencave islame*, si dhe përgatitjen e formimin e tyre, nëpërmjet gërshetimit të traditës, kulturës dhe realitetit bashkëkohor.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Kolegjut Universitar "Bedër" (KUB), si dhe urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institacioneve të arsimit të lartë", nën përgjegjësinë e titularit të njësisë, me propozim të Këshillit të departamentit dhe me vendim të Senatit Akademik u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin "Bachelor" në *Shkenca Islame*.²

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së janë marrë parasysh aftësitë dhe kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes së anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimi shët përmirësimi i vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij pesë (5) anëtarë, duke përfshirë edhe një (1) përfaqësues të studentëve.

Ky proces akreditimi për programin e studimit "Bachelor" në *Shkenca Islame* zhvillohet për herë të parë.

Projekti i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësinë bazë, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin përfundimtar të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB).

Etapat e procedurës së vlerësimit të brendshëm ndjekur për programin Bachelor në Shkenca Islame

- Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.
- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftimi zyrtar për fillimin e procesit të akreditimit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nga titullari i njësisë.
- Trajnim i GVB nga stafi i ASCAL; vënia në dispozicion e materialeve udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitet e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkese.

² Evidencia nr. 52 Vendim për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm (GVB)

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Shkenca Islame

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Kolegji Universitar "Bedër" (KU "Bedër") në rolin e tij si institucion me një mision të quartë dhe që thekson vlerat universale, synon të realizojë ide dhe projekte që kanë ndikim në përmirësimin e jetës së individit dhe shoqërisë. Programi i studimit "Bachelor" në Shkenca Islame është hartuar në mënyrë të tillë që të reflektojë interesat dhe përparësitë kombëtare. Synimi kryesor i këtij programi është përgatitja intelektuale dhe profesionale e specialisteve, të cilët janë aktivë dhe bashkëveprues, të integruar në shoqëri, zotërojnë vlerat universale dhe përfaqësojnë profesionin e tyre në mënyrën më të përshtatshme në qasje me kulturën, traditën shqiptare dhe atë evropiane si dhe në përputhje me zhvillimet e shekullit XXI. |
| Kriteri 2. Programi i studimit hartohej dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programet e studimit të Kolegit Universitar "Bedër" (KUB) shërbejnë për ruajtjen dhe forcimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. ³ Programi i studimit "Bachelor" në Shkenca Islame është konceptuar me synimin e përforcimit të vlerave akademike dhe kulturore në një shoqëri në zhvillim. Kjo përfshin natyrshëm respektimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare në të gjithë strukturën e këtij programi studimi, duke siguruar një formim të plotë dhe të gjithanshëm për studentët. Programi "Bachelor" në Shkenca Islame synon të ndihmojë studentët në përfshirje e aftësive të leximit dhe vlerësimit të burimeve klasike e bashkëkohore të Studimeve Islame, edukimin e studentëve në një mënyrë, që ata të përvetësojnë njohuri të thella në lidhje me aspektet fetare e sociale në harmoni me fushën e studimeve islame, si dhe përgatitjen e formimin e tyre, nëpërmjet gërshetimit të traditës, kulturës dhe realitetit bashkëkohor. Aktivitetet e shumta të organizuara nga Departamenti shërbejnë për të ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, duke theksuar përkushtimin e Kolegit Universitar "Bedër" në mbështetjen e një mjedisi arsimor të pasur dhe me diversitet. |
| Kriteri 3. Programi i studimit hartohej dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Shkencave Islame janë hartuar në përputhje me objektivat dhe misionin e Kolegit Universitar "Bedër" ⁴ duke u përqendruar në përgatitjen e individuve të aftë për të kuptuar dhe analizuar zhvillimet e reja në fushën e studimeve islame. Kurrikulat bashkëkohore të Departamentit të Shkencave Islame pranë Kolegit Universitar "Bedër" synojnë të përgatisin profesionistë të aftë të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat në fushën e shkencave islame, të denjë për tu integruar në një botë moderne me një botëkuptim bashkëkohor të Islamit ⁵ . Objektivat e programit janë të prezantuar në rregulloren e programit të studimit dhe në faqen e internetit të Departamentit, ku gjithashtu mund të gjeni informacione të detajuara mbi këtë program. www.isc.beder.edu.al |
| Kriteri 4. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programet e studimit të Departamentit të Shkencave Islame në Kolegin Universitar "Bedër" janë zhvilluar me kujdes dhe në përputhje me vizionin, objektivat dhe misionin e institucionit. Këto programe janë hartuar duke marrë parasysh kërkesat aktuale të tregut të punës në Shqipëri, si dhe duke u përshtatur me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare, e cila synon integrimin në Bashkimin Evropian, tregon e përbashkët evropian dhe atë ndërkombëtar. Kolegji Universitar "Bedër" |

³ Evidencia nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Beder 2024-2028

⁴ Evidencia nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegit Universitar Bedër

⁵ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

| | <p>është i vetmi institucion në Shqipëri që ofron programe studimi në këtë fushë arsimimi. Hapja e këtyre programeve është rezultat i nevojave të shprehura nga Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH) për formimin e kuadrove fetare për të gjitha instancat e tij jo vetëm brenda vendit, por dhe më gjërë në diasporë, në përputhje me traditën shekulllore të <i>Islamit</i> në trojet shqiptare, në bashkëjetesë me të gjithë bashkëkombësit e vet të besimeve të tjera fetare. Procesi i hartimit të këtyre programeve është kryer në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e nevojshme për licensim. Studimi i tregut të punës ka qenë një pjesë e rëndësishme e këtij procesi, dhe pas një analize të kujdeshme, KUB ka vendosur për programet që do të ofrohen, duke siguruar që ato të përbushin nevojat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë dhe tregut të punës në kontekstin vendas dhe ndërkombëtar⁶.</p> | | | | | | | | |
|---|--|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të <i>Shkencave islame</i> si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FShHD) ⁷ të Kolegji Universitar "Bedér" dhe realizon veprimitarinë e tij akademike në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Departamenti i <i>Shkencave islame</i> vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave islame dhe shkencave humane. Klasifikimi dhe kodifikimi i programit ⁸ të studimit bazohet tek vendimi i <i>Senatit</i> për kodifikimin e programit dhe lëndët e kurrikulës, në harmoni me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të <i>Shkencave islame</i> si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FShHD) ⁷ të Kolegji Universitar "Bedér" dhe realizon veprimitarinë e tij akademike në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Departamenti i <i>Shkencave islame</i> vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave islame dhe shkencave humane. Klasifikimi dhe kodifikimi i programit ⁸ të studimit bazohet tek vendimi i <i>Senatit</i> për kodifikimin e programit dhe lëndët e kurrikulës, në harmoni me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane. | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Kolegji Universitar "Bedér", për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë bazë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Në Kolegjin Universitar "Bedér" personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ janë të përfshirë në aktivitete në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të arritur këto objektiva. Përputhja mes kualifikimeve të tyre dhe programeve ku ata janë të angazhuar vërtetohet dhe shënon një faktor të rëndësishëm në suksesin e tyre. Në Departamentin e <i>Shkencave islame</i> , ka një shkallë të lartë bashkëpunimi dhe koordinimi mes personelit akademik dhe atij administrativ. Ky koordinim si dhe bashkëpunimi efikas ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, por dhe në arritjen e objektivave të tyre. Niveli i suksesit në përputhshmérinë me objektivat e programeve të studimit varet kryesisht nga efektiviteti i koordinimit dhe bashkëpunimit mes gjithë anëtarëve të personelit. Përfaqësuesit e të gjitha niveleve të kualifikimit në departament punojnë për të siguruar një mjesis arsimor dhe administrativ të përshtatshëm, duke përqendruar përpjekjet e tyre në mbështetjen e suksesit të studentëve dhe në përbushjen e synimeve të programeve të studimit. Ky përqendrim në bashkëpunim dhe koordinim ndihmon në krijimin e një atmosferë produktive në Departamentin e <i>Shkencave islame</i> . |

⁶ Evidencia nr. 24 Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame

⁷ Evidencia nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

⁸ Evidencia nr. 9 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përkthajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë"

Faqja 7



| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, KUB vndos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | <p>Kolegji Universitar "Beder" ka zhvilluar një politikë të përqendruar në bashkëpunim dhe partneritet me institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj. Kjo politikë promovon bashkëpunimin në shumë nivele dhe favorizon lëvizshmërinë e personelit akademik dhe studentëve. KU "Beder" ka vndosur marrëdhënie bashkëpunimi me institacione homologe në shumë vende, duke përfshirë ato në Evropë, si: Austri, Itali, por dhe jashtë saj, si: Egjipt dhe të tjera. Këto marrëveshje bashkëpunimi inkurajojnë shkëmbimin e ideve dhe përvojave në fushën e arsimit dhe shkencës. Për shembull, marrëveshjet e nënshkruara hapin rrugën për organizimin e konferencave ndërkombëtare, projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për organizimin e trajnimeve profesionale dhe stazheve studentore.⁹ Në këtë drejtim, KU "Beder" mundëson përfshirjen e studentëve në programe shkëmbimi me universitete partnere në disa vende të Evropës dhe më gjerë, duke rritur kështu mundësitë e tyre për përvojë ndërkombëtare dhe ndërtimin e një rrjeti të gjërë bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe shkencës. Kjo lëvizshmëri hapur ndihmon në përgatitjen e studentëve për sfidat e një bote globale.</p> | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|----------|
| Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucionet, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | <p>Kolegji Universitar "Beder" ka përqendruar vëmendjen në nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë për të nxitur frymën e formimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve profesionale. Në këtë drejtim, zyrat dhe departamentet e KU "Beder" ofrojnë një gamë të gjërë metodash dhe modulesh që synojnë të zhvillojnë aftësitë individuale dhe të mbajnë lidhjen e personelit me mjedisin arsimor. Kjo përpjekje për të ofruar formim të vazhdueshëm dhe trajnime profesionale përfshin një sërë shërbimesh dhe mundësish për zhvillim personal. KU "Beder" ka krijuar një mjedis ku personeli akademik, administrativ dhe studentët mund të përfitojnë nga trajnime, seminare, dhe aktivitete të tjera që i ndihmojnë ata të mbeten të informuar dhe të përmirësojnë kompetencat e tyre. Kjo përqasje ndaj formimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve profesionale shërben jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e aftësive individuale, por gjithashtu për të përgatitur komunitetin e Kolegit Universitar "Beder" për sfidat dhe mundësitë e ndryshme që ofron mjedisit akademik dhe profesional në përgjithësi.</p> | | | | | | | | |
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | <p>Departamenti i Shkencave islame, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit "Bachelor" në Shkencave islame, ka një përqasje sistematike në vlerësimin e marrëveshjeve të lidhura nga institucioni me organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Për të monitoruar dhe vlerësuar këto marrëveshje, Departamenti zhvillon një analizë periodike dhe harton një Raport vjetor, i cili është një dokument i rëndësishëm që përfshin një gamë të gjërë informacioni dhe dorëzohet pranë Rektorit. Pjesë e këtij reporti është analiza vjetore e punës akademike, kërkimore dhe bashkëpunimit me aktorët e jashtëm. Në report, Departamenti përfshin një analizë të detajuar në formën e analizës SWOT, e cila është një mjet efektiv për të vlerësuar situatën aktuale dhe perspektivat e ardhshme. Përmes një punë bashkëpunuese të personelit akademik dhe studentëve, identifikohen pikat e forta, elementet që duhen përmirësuar, mundësítë dhe rreziqet që Departamenti mund të përballet me to gjatë çdo viti akademik. Ky proces vlerësimi periodik dhe analiza SWOT ndihmon Departamentin e Shkencave islame të zhvillojë strategji efektive për përmirësimin e cilësisë së programeve studimore dhe të forcimit të bashkëpunimit me kompanitë dhe organizatat e ndryshme.¹⁰</p> | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td style="text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td><td></td><td></td><td style="text-align: center;">X</td></tr> </tbody> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

⁹ Evidenca nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale

¹⁰ Evidenca nr. 36 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame, viti akademik 2022-2023

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është i organizuar në tre (3) vite akademike, të ndara në gjashë (6) semestra. Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit, ku një (1) orë mësimore = 50 minuta. Një vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Një semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve. Formate kryesore të mësimdhënies janë përgjithësisht leksione të integruese me seminare (por edhe të ndara në leksione dhe seminare, varësish profilit së lëndës/modulit), detyrat e kursit, projektet, etj. Vlerësimi, sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS) nga pikëpamja akademike për leksionet/seminaret, projektet/detyra dhe punime të tjera të ngjashme, bëhet në bazë të njësisë matëse të zhvilluar "orë në auditor". ¹¹ |
| Kriteri 2. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuar kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Ky program studimi "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është hartuar me qëllim që të ofrojë një horizont intelektual dhe profesional studentëve, duke prezantuar një shumëlojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e shkencave juridike, me fokus të veçantë në studimet islame dhe jurisprudencën islame, duke përfshirë disa degë të rëndësishme, si: Hadithi dhe Tefsiri. Gjatë këtyre tre viteve, studentët do të thellojnë njohuritë e tyre, duke u përgatitur për të bërë një kontribut të rëndësishëm në organet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, medreseve, Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë dhe institucione të tjera në varësi të KMSH-së ¹² . Përveç kësaj, programi synon të nxisë studentët të angazhohen në punë kërkimore dhe shkencore, duke i përgatitur ata për të pasuar një karrierë, si studiues të kualifikuar dhe për të dhënë kontributin në fushën akademike, shkencore dhe humane në lidhje me <i>Shkenca islame</i> . Kjo përqasje pozitive mund të ndihmojë në zhvillimin e dijes dhe kulturës islame në kontekstin shqiptar dhe ndërkombëtar. ¹³ |
| Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kreditë. | Kurrikula e programit të studimit është formuluar dhe bazuar në kategoritë e lëndëve me ngarkesën e nevojshme të orëve, kreditet dhe përqindjet përkatëse. Shpërndarja e krediteve sipas veprimtarive formuese brenda një disiplinës përcaktohet nga departamenti në funksion të natyrës së disiplinës dhe shprehet në planet mësimore, si edhe në rregulloren e programit të studimit. Programi universitar i studimeve "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> , për vitin akademik 2022-2023, siguron ndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmbyllëse, duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore, si edhe kreditet përkatëse për çdo lëndë. Kjo shpërndarje është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Programi specifikisht të çdo |

¹¹ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

¹² Evidencia nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale

¹³ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame





Faqja 9




| | |
|---|---|
| | <p>lende janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr. 2 të VKM nr. 41 datë 24.01.2018, i ndryshuar, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"¹⁴, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut; • Përbledhjen dhe rezultatin e të nxenit; • Konceptet themelore, temat e lëndës; • Forma e kontrollit të dijeve, frekuencimi; • Kontrolli i vazhdueshëm, literatura; • Vërejjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës. |
| Kriteri 4. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | <p>Si një departament i bazuar në kërkesa profesionale dhe me synimin për të përgatitur profesionistë të një shoqërie demokratike dhe të një zhvillimi bashkëkohor, përmes këtij programi synohet përbushja e misionit institucional, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të një komunikimi të qartë, që të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka profesiioni i tyre në krijimin e një shoqërie të drejtë dhe në respektim të shtetit të së drejtës. Përmes një kurrikule të bazuar dhe të mbështetur në traditën e disa universiteteve perëndimore, programi synon të zhvillojë një botëkuptim të gjërë të teorive dhe praktikës në fushën e studimeve islame.</p> <p>Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> ka të përcaktuuar qartë ngarkesën në kredite sa i takon realizimit të detyrimeve përmbyllëse, si: provim përfundimtar/ punim diplome me përkatësisht 6 ECTS. Ndërsa përsë i përket praktikës profesionale, programi i studimit nuk e ka të parashikuar në planin mësimor, por departamenti në bashkëpunim me institucionin kujdeset për angazhimin dhe motivimin e studenteve në programe internshipi të ndryshme me institucione partnerë dhe më gjërë.¹⁵</p> |
| Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | <p>Organizimi i programeve të studimit, pranimi i studentëve dhe financimi bëhet në përpunje të plotë me kuadrin ligjor dhe specifikat përkatëse të parashtruara nga ministria përkatëse për arsimin pranë MAS¹⁶. Programet e studimit të ciklit të parë përbajnjë të gjitha elementet, që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Programi është hartuar dhe ndryshuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në rregulloren e programit dhe udhëzimet e dhëna nga Senati Akademik. E njëta gjë vlen edhe për pranimin dhe financimin e studentëve.</p> <p>Më konkretisht, siç dëshmohet nga <i>Rregullorja e programit të studimit</i>¹⁷, silabuset¹⁸ e lëndëve, programi është strukturuar duke përdorur kreditet (ECTS), si njësi matëse të ngarkesës studentore. Një vit akademik përban 60 ECTS (ose 1,500 orë mësimore), të ndara në dy semestra nga 30 ECTS secili, me ngarkesën neto brenda auditorit, që lëviz rrëth 25 orë në javë. Kontrolli i njohurive është i vazhdueshëm, formues e përbledhës dhe realizohet nëpërmjet një sërë elementesh, të tillë si teste me shkrim dhe me gojë, ese, detyra semestrale, projekte individuale ose në grup, prezantime, praktika profesionale studentore, etj. Rezultatet mësimore vijnë me realizimin e një sërë objektivash formuese, si dhe të kompetencave, që lidhen me zbatimin e teorisë dhe praktikën profesionale.</p> |
| Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | <p>Duke qenë se programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> i përket një karakteri të veçantë dhe është unik, prandaj nuk mund të flasim për një ngjashmëri të tillë me programe studimi të tjera të ciklit të parë, brenda Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FShHD).</p> |

¹⁴ Evidencia nr. 56 Udhëzim nr.15, dt. 04.04.2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë

¹⁵ Evidencia nr. 41 Rregullorja e Praktikës Profesionale

¹⁶ Evidencia nr. 56 Udhëzim nr.15, dt. 04.04.2008 për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë

¹⁷ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

¹⁸ Evidencia nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit

| Kriteri 7. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Departamenti i <i>Shkencave islame</i> shoqërohen me kodin përkatës dhe janë organizuar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e kërtuar nga MAS respektivisht (72MS 0221A) ¹⁹ . Ky program studimi shoqërohet me kodin përkatës dhe KU "Beder" ka kryer kodifikimin e programit në bazë të vendimit nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet Dhe Përbajtjen E Kodifikimit Të Programeve Të Studimit Të Ofruara Nga Institucionet E Arsimit Të Lartë në Republikën e Shqipërisë". | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 8. Programet e studimit mund të janë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> nuk është një program i përbashkët me një institucion tjeter të arsimit të lartë vendas ose të huaj. | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FShHD) është çelur me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nr. 286, datë 6.4.2011, si një nga njësítë kryesore të Kolegit Universitar "Beder" (KU "Beder") dhe të gjitha programet, që ofron janë të akreditura. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka në përbërje të tij katër njësi bazë, ku secila prej tyre ka minimumi shtatë (7) anëtarë personel akademik me kohë të plotë dhe ku minimalisht tre (3) prej tyre mbajnë gradën shkencore "Doktor i shkencave", kjo në përputhje me ligjin e arsimit të lartë ²⁰ . Fakulteti i Shkencave Humane dhe të Drejtësisë, si dhe Departamenti i <i>Shkencave islame</i> , si njësi bazë, zotërojnë një strukturim organizativ në çdo shkallë të hierarkisë, duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit dhe përbushin detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim. |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Personeli i Departamentit të <i>Shkencave islame</i> , pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë përbëhet nga personeli akademik dhe personeli administrativ. Të drejtat dhe detyrat e tyre, si dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës me të gjitha elementet përbërëse për çdo kategori personeli të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë janë parashikuar në <i>Rregulloren themelore</i> të Kolegit Universitar "Beder" dhe në rregulloret e tjera përkatëse. ²¹ Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit. |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit | Departamenti i <i>Shkencave islame</i> , pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në nenin 10 të <i>Rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i> ²² është parashikuar se |

¹⁹ Evidencia nr. 9 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë"

²⁰ Evidencia nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

²¹ Evidencia nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegit Universitar Beder

²² Evidencia nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë



| | | | | |
|---|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | programi i ciklit të parë ka një koordinator të veçantë ²³ , i zgjedhur nga komiteti shkencor. Në mungesë të tij, ky funksion i ngarkohet përgjegjësit të departamentit ²⁴ . | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti i Shkencave islame pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë disponon informacionin e duhur për strukturimin e programit. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga <i>Plani Strategjik Institucional, Statuti i Kolegit Universitar "Bedër"</i> ²⁵ , <i>Rregullorja themelore</i> e Kolegit Universitar "Bedër", <i>Rregullorja e Fakultetit</i> të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, <i>Rregullorja e programit të studimit</i> e deri te <i>Rregullorja e zyrës së Sekretarisë mësimore</i> . ²⁶ Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të KU "Bedër" dhe të zbatueshëm nga të gjithë. ²⁷ |
| Kriteri 2. Programi i studimit përban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> përban të gjitha informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. ²⁸ Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në programet e lëndëve me një shpërndarje përafersisht si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - 10 % pjesëmarra; - 10 % projekte, kuice; - 30-40 % testimet gjatë semestrit; - 40-50 % provimi përfundimtar. Për frekuentimin e studentëve, KU "Bedër" ka vendosur detyrim 75% (për qind) për programet e ciklit të parë të studimeve. Në planin mësimor janë përfshirë kreditet përkatëse për çdo lëndë apo aktivitet formues. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> i ka të dokumentuara të gjitha silabuset e lëndëve. Në to janë paraqitur në mënyrë të detajuar elementet përkatëse: emërtimi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet lënda, emri dhe kualifikimi i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit, njojuritë dhe aftësitet që i jep studentit kjo lëndë, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe në ECTS, formati dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raport in midis tyre, format e vlerësimit të studentëve dhe detyrimet e tyre për lëndën, si dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse, respektimin e <i>Kodit të etikës</i> ²⁹ , duke qenë në përputhje me kërkuesat ligjore. |

²³ Evidencia nr. 48 Vendimi për caktimin e Koordinatorit të Programit Bachelor

²⁴ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

²⁵ Evidencia nr. 2 Statuti i Kolegit Universitar Beder

²⁶ Evidencia nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

²⁷ Shih faqen web: www.qac.beder.edu.al

²⁸ Evidencia nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit

²⁹ Evidencia nr. 17 Rregullorja e disiplinës së personelit akademik dhe administrativ



| Kriteri 3. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> përban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekivalenzimit të studimeve. | Pranimi dhe regjistrimi i studentëve në programin e studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> , transferimi, si dhe njehsimi i studimeve janë parashikuar në <i>Rregulloren e programit të studimit</i> ³⁰ , si dhe në <i>Rregulloren e transferimit të studimeve</i> ³¹ . Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit për programin e studimit propozohen nga departamenti ³² dhe miratohen nga Senati Akademik, i cili brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dërgon në MAS, QSHA dhe RASH kriteret e pranimit për programin e studimit. Kriteret publikohen në portalin <i>U-Albania</i> dhe në faqen zyrtare të KU "Bedër", të cilat janë të disponueshme për të gjithë të interesuarit. | | | | | | | | |
|---|--|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 4. Programi i studimit përban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formuese të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuar. | Programet e lëndëve përbajnjë informacionet e nevojshme për leksionet, praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentet formuese të programit, brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuar. Silabuset ³³ për secilën lëndë janë të plota dhe të pajisura me të gjitha elementet e nevojshme: <ul style="list-style-type: none"> • Pedagogu i lëndës; • Përbledhjen dhe rezultatet e të nxënët; • Përcaktimin e lëndës si të detyrueshme ose me zgjedhje; • Konceptet themelore që do të trajtohen gjatë semestrit; • Orët në auditor dhe ato si punë individuale; • Temat e programit mësimor të lëndës specifike; • Formën e kontrollit të dijeve; • Literaturën bazë, literaturën ndihmëse; • Kreditet e mundshme, etj.; • Kërkesat/udhëzimet për respektimin e <i>Kodit të etikës</i>. Të gjithë këto elemente janë në përputhje me formatet e kërkua nga legjislacioni në fuqi. | | | | | | | | |
| Kriteri 5. Përbajtja e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Programi është ndërtuar dhe bazuar në eksperientat e universiteteve më të mira si nga bota islame, ashtu edhe nga universitetet perëndimore. Për t'u theksuar mbetet praktika që njësi bazë ndjek për rishikimin dhe përditësimin e programit dhe silabuseve në çdo fillimviti akademik, të propozuara këto nga titullari i lëndës dhe të miratuar nga përgjegjësi i njësisë bazë. | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënët dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.


| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Emërtimi, përbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime | Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira të universiteteve publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit. Emërtimi, përbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike, si dhe praktikat e ndryshme brenda dhe jashtë kurrikulare u mundësojnë studentëve njohur teorike dhe praktike |

³⁰ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

³¹ Evidencia nr. 25 Rregullorja e transferimit të studimeve

³² Evidencia nr. 13 Praktika e ndjekur për miratim të kritereve të pranimit të studentëve Bach

³³ Evidencia nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit



| | |
|---|--|
| të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët e KUB në tregun e punës. Emërtimi, përbajtja e veprimitarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. |
| Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësit. | Tabela e planit mësimor për programin e studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> pasqyron ndarjen e ngarkesës së veprimitarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, në komponentet mësimore: a) mësim në auditor, si: leksione, seminare, punë individuale, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; b) punim individual, si: studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; c) përgatitje për provime; d) përgatitje e tezës; e) veprimitari të tjera, si: praktika profesionale, praktika në terren apo stazhe pranë subjekteve publike ose private. ³⁴ Në këtë plan mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet edhe përgatitjes praktike profesionale të studentëve, nëpërmjet aplikimit të praktikave profesionale, stazheve (kurrikulare dhe ekstrakurrikulare), detyrave dhe projekteve me karakter praktik, pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, që kanë për qëllim arritjen e objektivave të programit të studimit, vëzhgimit dhe zbatimit në praktikë të koncepteve dhe teorive të mësuara në auditor me qëllim përvetësimin më të mirë të tyre. |
| Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë eshtë në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkontinentare. | Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë eshtë në përputhje me profilin e programit bachelor. Struktura e programit eshtë krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe eshtë e përafërt me programe të ngjashme ndërkontinentare, duke pasur parasysh edhe profilin e këtij programi. |
| Kriteri 4. Ndarja sipas veprimitarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Raportet e ndarjes midis veprimitarise formuese të planit mësimor të programit të studimit, sipas kategorive, janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Lëndë bazë (A) • Lëndë karakterizuese (B) • Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) • Lëndë plotësues (D) • Detyrime përbyllëse (E) Kjo ndarje eshtë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi i saj paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësim nxënies. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren në kuadrin e lëndës së praktikës profesionale. Në lëndën praktika profesionale studentët duhet të përfshihen rregullisht në praktikën e tyre në institucione publike dhe private, dhe duhet të paraqesin dëshmi të pjesëmarrjes dhe angazhimit si parakusht përfundimin e lëndës dhe diplomimin në fund të programit. |
| Kriteri 5. Silabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme përmarrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Në fillim të semestrit të çdo viti akademik, pedagogu i lëndës eshtë i detyruar të ngarkojë në sistemin informativ <i>Beder Information System (BIS)</i> ³⁵ planin (silabusin) e lëndës, që jep bashkë me përditësimet e nevojshme, duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse; gjithashtu programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit. Departamenti i <i>Shkenca Islame</i> në fillim të çdo viti akademik realizon një mbledhje për përditësimin e silabuseve me anëtarë të këshillit të departamentit, të cilët janë edhe lektorë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Gjatë kësaj mbledhjeje bëhet analiza e disa prej silabuseve të lëndëve dhe diskutohen midis pedagogëve mënyrat e ndryshme të përdorur prej tyre për përditësimin e silabuseve të lëndëve çdo vit akademik, duke shkëmbhyer edhe |

³⁴ Shih tabelën numër 10.

³⁵ Evidencia nr. 35 Udhëzues i sistemit informativ BIS



| | eksperientat mbi metodat më efektive. Gjithashtu trajtohet domosdoshmëria e përdorimit të terminologjive dhe tematikave të kuptueshme për studentët, duke i dhënë përparësi marrjes së njohurive bazë në fillim për të vijuar më tej me brendësinë e lëndës. | | | | | | | | |
|---|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 6. Përbajtja e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Emërtimi dhe përbajtja e lëndëve të programit të studimit është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira pozitive të disa prej universiteteve më të mira ndërkombe. Kjo së bashku me vijimësinë midis natyrës së lëndëve i ndihmon studentët, që të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike, çka garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe kërkuese. | | | | | | | | |
| Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit mundeson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut e punës. | Përbajtja e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tillë, që krijojnë te studenti një bazë shumë të mirë për vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshmë të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnerë, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjera nga tregu i punës. | Departamenti i <i>Shkencave islame</i> ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë në fushën përkatëse, me institucionë shtetërore dhe/ose private. ³⁶ Roli i tyre ka qenë i rëndësishëm në përshtatjen, që i është bërë kurrikulës së programit bazuar edhe në studimin e tregut. Nga të dhënat e nxjerra nga komunikimet me partnerët dhe studimi i tregut janë realizuar dhe përditësimet e kurrikulës. Departamenti organizon takime të vazhdueshme me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës. Zyra e <i>Planifikimit të karrierës</i> në bashkëpunim me departamentin organizon takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës për t'i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve të mundshëm. ³⁷ |
| Kriteri 2. KUB nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohen vazdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Në mbledhjet e Këshillit të Departamentit marrin pjesë përfaqësues të studentëve. Studentët përcjellin mendimin dhe vlerësimin e grupit mbi programin dhe lëndët specifike. Gjithashtu, pjesëmarrja aktive në anketën, që realizohet për çdo lëndë në përfundim të semestrit është një mënyrë tjetër sesi studentët ndikojnë në përmirësimin e programit. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Ky program studimi akreditohet për herë të parë. |
| Kriteri 3. Departamenti si njësi përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjetë profesionistësh si dhe institucionë publike e private në fushën e studimit të gjuhës angleze. Një praktikë e konsoliduar e departamentit është përditësimi i silabuseve në fillim të çdo semestri dhe viti akademik. Politika e | Për të realizuar përmirësimin e përbajtjes së këtij programi studimi, departamenti, si njësia përgjegjëse e programit përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjetë profesionistësh si dhe institucionë publike e private në fushën e studimit të gjuhës angleze. Një praktikë e konsoliduar e departamentit është përditësimi i silabuseve në fillim të çdo semestri dhe viti akademik. Politika e |

³⁶ Evidencia nr. 74 Lista e institucioneve me të cilat KU Bedër ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunim me fusha të ndryshme

³⁷ Evidencia nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale

Faqja 15



| | | | | |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucion publike e private. | përmirësimit dhe përditësimit të programeve të studimit parashikon përfshirjen e bashkëpunëtorëve të ndryshëm në këtë proces. | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Format e mësimdhënies, të parashikuara në rregulloren e institucionit ³⁸ dhe në përputhje me karakteristikat e programit të studimit, përfshin leksionet, seminaret, ushtrimet, praktikat mësimore dhe profesionale, si dhe provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, ese, etj. ³⁹ Përveç metodave të lartpërmendura, janë organizuar ndërkaq konferanca, trajnime, leksione të hapura dhe seminare me ekspertë të fushës në baza periodike. Në kontekst të veçantë, vlen të theksohet edhe realizimi i shkollës verore dy mujore në Kajro, Egjipt, ku morën pjesë studentët e këtij programi. ⁴⁰ |
| Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Kombinimi i metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke marrë parasysh shumëlojshmérinë e nevojave të studentëve, shfaqet në përditësimin e syllabuseve të lëndëve për çdo vit akademik. Ky përditësim përfshin edhe përshtatjen e formave të reja të mësimdhënies, duke i përshtatur ato sipas kërkave të kohës dhe në mbështetje të studentëve. Në të njëjtën kohë, përfaqësues të studentëve janë pjesë e takimeve periodike të këshillit të departamentit. Ata sjellin në këto mbledhje mendimet dhe shqetësimet e studentëve, duke parashtruar propozime, ankesa dhe kërkesa. Këto elemente marrin peshë në vendimmarjen e këshillit të departamentit, duke kontribuar në përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat aktuale të studentëve. Gjithashtu, personeli akademik i Departamentit të <i>Shkencave islame</i> angazhohet për përmirësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, me synim që të përshtaten më mirë me nevojat e studentëve ⁴¹ . Përshtatja dhe përditësimi i silabuseve si dhe mekanizmi i anketimit dhe analizimi i të dhënave të grumbulluara shërbijnë si një mjet efektiv për të reflekta dhe adresuar nevojat e studentëve në mënyrë të shëndetshme. ^{42 43} |
| Kriteri 3. KUB mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësit. | Në kuadër të planit strategik të Kolegit Universitar "Bedër" për periudhën 2024-2028 ⁴⁴ , një nga objektivat kryesore është sigurimi dhe rritja e cilësisë arsimore, që i pajis studentët me aftësi praktike për t'u përshtatur më mirë me mjeshterin e ardhshëm të punës. Për të arritur këtë synim, planifikohet bashkëpunimi ndërmjet departamenteve për ofrimin e lëndëve, duke kombinuar leksionet, praktikën mësimore dhe punën praktike në mënyrë të koordinuar. Në një këndvështrim tjetër, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme. Përveç kësaj, realizohen trajnime për personelin akademik me qëllim përmirësimin e metodave didaktike. Kjo ndërhyrje synon të sigurojë që stafi pedagogjik të jetë sa më i përgatitur dhe i përshtatshëm për të mbështetur objektivat formuese, nevojat e studentëve dhe kërkuesat e tregut të punës. Për të përshtapjetuar këtë zhvillim, Kolegji Universitar "Bedër" vazhdon të investojë në zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të tij, duke përmbrushur në mënyrë të qëndrueshme vizionin dhe misionin e tij. ⁴⁵ |

³⁸ Evidencia nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegit Universitar Bedër

³⁹ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

⁴⁰ Evidencia nr. 29 Mobiliteti i stafit dhe studentëve

⁴¹ Evidencia nr. 29 Mobiliteti i stafit dhe studentëve

⁴² Evidencia nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

⁴³ Evidencia nr. 32 Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit

⁴⁴ Evidencia nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Beder 2024-2028

⁴⁵ Evidencia nr. 79 Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2023



| | |
|--|--|
| Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmérinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | <p>KU "Bedér" synon të tërheqë profesionistë të fushës, pedagogë të kualifikuar me tituj dhe grada shkencore në përputhje me synimet dhe standartet e përcaktuara në <i>Planin strategjik</i>⁴⁶ të institucionit. Në përbushje të nevojave për një personel akademik me tituj e grada shkencore, KU "Bedér" ndjek politikat e punësimit të profesionistëve vendas dhe të huaj me eksperiencë në fushën akademike. Në bazë të CV-ve⁴⁷ të personelit vërtetohet se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme, janë kompetentë në shpjegimin dhe dhënien e njohurive, koncepteve për të plotësuar objektivat e programit. Në përbërje të personelit akademik ka pedagogë me formim në fushën e <i>Shkencave islame</i>, të njohjes profesionale dhe komentimit të <i>Kuranit</i>, jurisprudencës Islam, tefsirit, edukimit fetar, dialogut ndërfetar, historisë Islam, historisë së feve, filozofisë, etj., marrë në universitete si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimore, duke iu përshtatur tipologjive të lëndëve dhe mundësive për një mësimnxënje efikase me në qendër studentin. Për më tepër, personeli akademik angazhohet në mësimdhënien përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive të studentëve.</p> <p>Departamenti i <i>Shkencave islame</i> përdor metoda pedagogjike shumë të larmishme, përvëç metodave tradicionale të mësimdhënies, siç janë leksionet dhe seminaret. Studentët marrin pjesë në projekte, dorëzojnë detyra, kryejnë prezantime të punimeve të tyre studentore etj. Kjo shumëlojshmëri e metodologjisë së mësimdhënies është shumë interaktive. Gjatë leksioneve dhe seminareve studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p>Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se Departamenti i <i>Shkencave islame</i> është përpjekur të përfshijë interaktivitetin në mësimdhënien përmes projekteve të ndryshme të realizuara nga studentët, në kuadër të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet individëve të ftuar si përfaqësues të agjencive, bizneseve dhe institucioneve publike dhe jopublike. Leksionet e hapura me figura të ndryshme publike, bëjnë të mundur pasurimin e metodave të mësimdhënies. Për të mundësuar realizimin sa më praktik dhe zbatues të koncepteve dhe konkretizimit të lëndëve, vizitat studimore pranë institucioneve dhe bizneseve të ndryshme si dhe organizimi i praktikave profesionale për studentët, bëjnë të mundur përfshirjen, aktivizimin e studentëve dhe praktikimin e dijeve të marra gjatë leksioneve.</p> |
| Kriteri 5. Departamenti i <i>Shkencave islame</i> si njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | <p>Siqë është përmendor edhe më lart, institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies edhe studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Instrumenti që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies është pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës, i cili kryhet në fund të çdo semestri. Pyetësori aktivizohet në sistemin BIS para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbylljet para finalizimit të notave përfundimtare të lëndës në sistem. Studentët plotësojnë pyetësorët, ku pyeten për performancën e lektorëve, si dhe metodat apo format që secili pedagog aplikon gjatë lëndës së tij. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe siguron ruajtjen e anonimitatit të studentëve gjatë realizimit të anketimeve.⁴⁸</p> <p>Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të KU "Bedér" si një kontribut për përmirësimin e mëtejshme. Në kuadër të përmirësimit të veprimit tarive mësimore dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore, Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjsBC) sugjerojnë seminare dhe aktivitete të ndryshme trajnimi, të mbajtura nga pedagogë nga vendi dhe ndërkombëtarë.⁴⁹</p> |
| Kriteri 6. KUB organizon struktura/njësi në nivel institucional që | Aspekti i përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi |

⁴⁶ Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Bedér 2024-2028

⁴⁷ Evidenca nr. 16 CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

⁴⁸ Evidenca nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

⁴⁹ Evidenca nr. 71 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik




Faqja 18




| | |
|---|--|
| <p>promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitet kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitat përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit, i cili është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit.⁵⁰⁵¹</p> <p>Përveç organizimit në nivel institucional, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënien. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat që kanë njësitet në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimit të bërrë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë.⁵²⁵³⁵⁴⁵⁵⁵⁶ http://qac.beder.edu.al/</p> <p>Departamenti i Shkencave islame si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) - si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Metodat kryesore përfshijnë përfitimini e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve PPT, platformave multimodale, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore,⁵⁷ leksioneve të hapura, aplikimeve studimore, ndërveprimit me të ftuar nga industria që vizitojnë institucionin, praktikave profesionale, vizitave në terren, aktivitetet e vullnetare, projekteve dhe anëtarësimeve në klubet studentore dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollorë.</p> <p>Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies është çështje që lidhet si me anën infrastrukturore të institucionit, ashtu edhe me strategjinë e cilësisë së KU "Bedër".</p> |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|--|
| Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, | Kolegji Universitar "Bedër" i pajis studentët me Guidën e studentit ⁵⁸ , e cila informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe në faqen zyrtare të KU "Bedër". Të tillë informacione bëhen të ditura edhe nëpërmjet marrëveshjes që studenti lidh me institucionin. Rregullorja themelore ⁵⁹ e KU "Bedër", Rregullorja e fakultetit ⁶⁰ , Rregullorja e programit "Bachelor" në Shkencave islame ⁶¹ , rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë parashikojnë në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit |

⁵⁰Evidencia nr. 18 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë

⁵¹Evidencia nr. 40 Vendim i senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme

⁵²Evidencia nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC

⁵³Evidencia nr. 30 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve

⁵⁴Evidencia nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët

⁵⁵Evidencia nr. 71 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik

⁵⁶Evidencia nr. 62 Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit

⁵⁷Evidencia nr. 27 Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore

⁵⁸Evidencia nr. 43 Guida e Studentit

⁵⁹Evidencia nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegit Universitar Beder

⁶⁰Evidencia nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

⁶¹Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkencë Islame



Faqja 19

| | |
|---|--|
| bëhen publike dhe njihen nga studentët. | dhe përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga pedagogët në lëndët e ndryshme. Procesi i vlerësimit përfshin elementë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij perfundimtar. Pesha e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lënda në lëndë. |
| Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në silabusin e lëndës përkatëse, pedagogu përcakton me detaje kërkesat dhe detyrimet që duhet të përmblidhen nga studentët gjatë gjithë kohës së semestrit, duke përfshirë edhe mënyrën e vlerësimit për këto detyrime. Këto informacione komunikohen me studentët në fillim të semestrit nga pedagogu dhe gjithashtu janë të publikuara në sistem BIS, në hapësirën e veçuar të kushtuar lëndës. Këtu, të gjithë studentët dhe pedagogu i lëndës kanë qasje dhe mundësi për të shfletuar detajet e kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara. Kjo qasje transparente siguron që të gjithë pjesëmarrësit në lëndë të kenë informacion të quartë dhe të përbashkët për parashikimet e semestrit dhe kriteret e vlerësimit. Nëpërmjet këtij procesi, studentët kanë mundësi të kuptojnë me precizion çfarë pritet nga ta gjatë semestrit dhe si do të vlerësohen për punën e tyre. Silabuset e lëndëve për të gjitha semestrat, kur është dhënë kjo lëndë, janë gjithashtu të publikuara në website-in e institucionit e programit përkatës www.beder.edu.al ⁶² |
| Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njojurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njojuritë dhe kompetencat e fituara. | Pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për t'u dhënë mundësi studentëve të shprehin dhe paraqesin njojuritë dhe aftësitë e përfshitura. Këto forma përfshijnë: testime gjysmëfinale, projekte semestrale, detyra kursi, kuice, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në leksione, provime finale, etj. Këto forma u jepin mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njojuritë e përfshitura, por edhe njojhen me forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njojurive dhe aftësive, zhvillimin e aftësive të punës në grup, të komunikimit me njëritjetrin dhe me palët e treta, të aftësive prezantuese, analizuese, vlerësuese, si dhe aftësinë për të dhënë rekomandime për përmirësimin e situatave të caktuara. |
| Kriteri 4. Njësia bazë/personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metoda e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektouar mendimet e sugjerimet e tyre. | Siq përmendet edhe më lart, studentët përfshihen në vlerësimin e metoda e mësimdhënies së pedagogëve nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. Pyetësori i vlerësimit të pedagogëve dhe të lëndës plotësuhet në perfundim të çdo semestri dhe përban pika si (i) përpikëria e pedagogëve; (ii) përgatitja e lëndës; (iii) zotërimi i njojurive të lëndës; (iv) materiali i lëndës; (v) ndërveprimi me studentët; (vi) metoda e mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së studentëve e menaxhimi i kohës. Në perfundim, të dhënat e përfshitura nga pyetësoret, nëpërmjet njësisë bazë i transmetohen personelit akademik përkatës. Ky i fundit ka mundësi të reflektojë mbi mendimet e sugjerimet e bëra nga studentët. Gjithashut, një formë tjetër e vlerësimit të punës së pedagogëve realizohet dhe nëpërmjet Formularit të vlerësimit të vazhdueshëm. Ky formular përdoret për të realizuar vlerësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në programet e studimit të KU "Bedér". Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është të identifikojë dhe promovojë pikat e fortë dhe të ofrojë sugjerime për përmirësimin e rast se është e nevojshme. ⁶³ |
| Kriteri 5. KUB mundëson përdorimin e metoda të shumëlojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metoda e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi | Institucioni ka ndër objektiva e tij strategjikë sigurimin e një arsimi cilësor të reflektoar në procesin e mësimdhënies dhe atë të vlerësimit, ku kërkohet të aftësohen studentët të mendojnë në mënyrë kritike e të pavarur. Puna në grup dhe projektet janë ndër format e përdorura që inkurajojnë autonominë dhe pavarësinë te studentët. Puna në grupe nxit studentët të bashkëpunojnë me njeri-tjetrin dhe të synojnë realizimin dhe perfundimin me sukses të detyrës së dhënë. Kjo përgjegjësi që u jepet, i stimulon të punojnë të pavarur duke ndërvepruar me anëtarë të tjerë. Ndërkohë, mbështetja e vazhdueshme e mësimdhënësve ndaj studentëve e nxit dhe përmirëson këtë proces. Pedagogët ofrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe asistencë duke marrë kujtimin e |

⁶² Evidencia nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit

⁶³ Evidencia nr. 75 Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies

Faqja 20



| | | | | |
|--|---|----------------------|---------------------|-------------------------------|
| dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | vetëbesimit tek studentët. Gjithashtu, pedagogët ofrojnë lehtësi komunikimi me studentët nëpërmjet platformave të ndryshme. ^{64 65 66} | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht X |

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Testimi e vlerësimi i nivelit të suksesit të studentëve të programit realizohet përgjatë gjithë semestrit akademik. Gjatë një semestri janë përcaktuar dy periudha kohore të kushtuara për provimet: provimet e ndërmjetme - gjysmëfinale (java e tetë e semestrit) dhe provimet përfundimtare - finale (përfundimi i semestrit, java e 15-të dhe e 16-të e semestrit). Ndërmjet tyre, studentët testohen me quize, teste, projekte, detyra, pjesëmarrje në mësim, etj. Sipas syllabusit përkates ⁶⁷ , vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale; pjesëmarrjes aktive në mësim; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Vlerësimi i lëndës bëhet sipas rregulloreve përkatëse si dhe modaliteteve të përcaktuara për lëndën në silabusin e saj. Sipas <i>Rregullores themelore</i> të KU "Bedër", ⁶⁸ duhet të ketë minimalisht një provim gjysmëfinal dhe një përfundimtar për se cilën lëndë në semestër. |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmanqin formë të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | KU "Bedër" disponon sistemin e brendshëm online BIS, ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Gjithashtu, mund të aplikohen teste me forma elektronike, të cilat rrisin transparencën dhe eliminojnë formë të ndryshme abuzimi. Kjo realizohet nëpërmjet formave të testimeve në platformën <i>G-Suite</i> . |
| Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Një lëndë mund të ketë një titullar dhe një asistent, të cilët bëjnë vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Provimet vlerësohen nga pedagogu/titullari i lëndës ose nga komisioni i pedagogëve në varësi të lëndës specifike në përputhje të plotë me silabusin e lëndës si dhe me bazën ligjore në fuqi. Detyrat, prezantimet në auditor, projektet, rastet studimore etj., vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mësimor, në disa raste edhe nga një pedagog i ftuar. Prezantimet e punimeve të tezave të studentëve realizohen në prezencë të një komisioni prej tre anëtarësh të stafit akademik, i cili përcaktohet nga këshilli i departamentit. Ky komision, në përbërje të të cilit është edhe pedagogu udhëheqës i studentit, vlerëson punimin dhe prezantimin e paraqitur nga studenti. |
| Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënët për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Shpalja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Në rastet e nevojshme, pedagogu është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë. Po ashtu pedagogu mund të shfojë kohën e nevojshme për përvetësimin e njohurive nga ana e studentëve, ose këtë mund ta bëjë me një grup të vogël studentësh. |

⁶⁴ Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit

⁶⁵ Evidenca nr. 42 Guida e stafit

⁶⁶ Evidenca nr. 43 Guida e studentit

⁶⁷ Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit

⁶⁸ Evidenca nr. 5 Rregulloja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër



| | |
|---|---|
| Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagiaturën, kopimin në provime dhe detyra. | KU "Bedër" nëpërmjet <i>Rregullores për disiplinën e studentëve</i> ⁶⁹ , dënon kopjen dhe plagiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Personeli akademik përgjegjës për punime të ndryshme detyrash dhe tezash, bën kontrollet e duhura të plagiaturës me anë të platformave të vëna në dispozicion nga institucioni. ⁷⁰ |
| Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Kolegji Universitar "Bedër" bën të ditur kalendarin e tij akademik në fillim të çdo viti akademik. Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë dhe të shpallura në kalendarin akademik. Ky kalendar pasqyrohet edhe në sistemin e brendshëm BIS, i cili është mënyra zyrtare e afishimit të rezultateve. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të bazuara plotësisht në meritë dhe jepen në kohë, duke respektuar përcaktime dhe udhëzimet e rregullores së institucionit. Kjo siguron një vlerësim objektiv dhe të drejtë për studentët, duke përcjellë një proces transparent në shpalljen e rezultateve. Në fund të semestrit pedagogu i lëndës dorëzon dosjen e provimit, e cila është e plotë në përbajtje, duke përfshirë fletë e provimit, fletë-përgigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të procesverbalit të notave përfundimtare, sipas rregullores përkatëse. |
| Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njojur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Sipas <i>Rregullores së programit</i> ⁷¹ "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> dhe <i>Rregullores së studimeve</i> dhe provimeve të ciklit të parë ⁷² , në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtë që brenda një javë nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e <i>Sekretarisë mësimore</i> . ⁷³ |
| Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komision i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivoitet. | Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të këshillit të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e studimeve përkatëse, dokumentohet dhe arkivoitet pranë departamentit. ⁷⁴ |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |
| | X |

Standardi III.4

Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënie së programet e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> duhet të garantojë thellimin e njohive, të zhvillojë aftësitetë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> u ofron studentëve njohuri, dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Krahas njohive shkencore-teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet praktikave. ⁷⁵ Lëndët e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> zhvillohen duke u dhënë rëndësinë e duhur teorisë, seminareve, projekteve, rasteve studimore dhe po ashtu praktikave profesionale. Nëpërmjet marrëveshjeve me organizata dhe shoqata të ndryshme në vend, KU |

⁶⁹ Evidencia nr. 53 Rregullorja për disiplinën e studentëve

⁷⁰ Evidencia nr. 81 Platforma digitale për kontrollin e plagiaturës

⁷¹ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

⁷² Evidencia nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

⁷³ Evidencia nr. 26 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

⁷⁴ Evidence nr. 54 Procedurë ankimimi

⁷⁵ Evidencia nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame



| | |
|--|---|
| | <p>"Bedér" u siguron studentëve praktika profesionale cilësore ⁷⁶. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtëkurrikulare, siç janë: forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore, etj.⁷⁷</p> |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> është i fokusuar në risitë bashkëkohore të studimeve islame. Ai garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e studimeve bashkëkohore të feve, gjë e cila vërtetohet edhe nëpërmjet literaturës mbështetëse është literaturë e huaj të ofruar në departament. Stafi është kujdesur që të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset, sipas kërkesave të kohës duke përfshirë të rejat e fushës. |
| Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët përzbatimin e tyre dhe përdetyrimet përbyllëse. | Në përfundim të një semestri, pedagogu i lëndës sigurohet me anë të mjeteve të tij vlerësuese që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe të jenë plotësuar. Kjo paraqitet edhe në anketën e vlerësimit që plotësohet nga studentët për lëndët dhe lektorët në mënyrë periodike, çdo vit. ⁷⁸ Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku secila prej palëve paraqet konkluzionet përkatëse për njojuritë dhe shprehitë e fituara, duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit. Gjithashtu, studentët marrin udhëzime konkrete për format e zbatimit të njojurive dhe të aftësive të fituara, nëpërmjet praktikave profesionale në kompani apo institucionet e ndryshme. |
| Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njojuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme përzbatimin e ideve inovative, studime të përparuarë kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënieve me institucionet bashkëpunuese përmundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirë përcaktuara në programet lëndore. Studentët e programit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë përmundësuar të zhvilluar njojuritë e përfituarë gjatë përgjatë leksioneve. Departamenti ka ndërmjetësuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar "Bedér" me institucionet e tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Krashtë ndërmjetësimit, Departamenti i <i>Shkencave islame</i> ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e fushës si Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, KNFSH, medresetë, institucionet dhe organizma ndërkombëtare, që operojnë në fushën e studimeve të feve, me qëllim realizimin e programit. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunime të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të departamentit. ⁷⁹ Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e Programit "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> . Personeli akademik organizon diskutime si në lidhje me problematika brenda departamentit, ashtu edhe për çështje të ndryshme sociale apo në lidhje me komunitetin, ku herë pas here janë të ftuar edhe përfaqësues të studentëve, në bazë të tematikave. Zakonisht mbahen mbledhje të tjera periodike përmundësuar e kurseve e vendimeve të mbledhjeve të mëparshme. <i>Rregullorja mbi kërkimin shkencor</i> ⁸⁰ përcakton mënyrën e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitet e organeve kompetente dhe kërkuesve shkencorë, duke përfshirë revistat shkencore, konferencat, projektet kërkimore, publikimet individuale dhe veprat tarinë kërkimore të studentëve, nëpërmjet procedurave që zbatohen në Kolegjin Universitar "Bedér". Studentët gjithashtu inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekteve, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminarë dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjes bilaterale për shkëmbimin e studentëve, ku mund të përmendim marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Universitetin e Vjenës (Austri), Universitetin e Kairi (Egipt), |

⁷⁶ Evidencia nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera përmundësuar të realizimin e praktikave profesionale

⁷⁷ Evidencia nr. 36 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame

⁷⁸ Evidencia nr. 33 Anketa vlerësuese përmundësuar të lëndëve dhe pedagogon nga studentët

⁷⁹ Evidencia nr. 74 Lista e institucioneve me të cilat KU Bedér ka marrëveshje partneriteti përbashkëpunime në fushë sociale apo në lidhje me komunitetin, ku herë pas here janë të ftuar edhe përfaqësues të studentëve, në bazë të tematikave. Zakonisht mbahen mbledhje të tjera periodike përmundësuar e kurseve e vendimeve të mbledhjeve të mëparshme. *Rregullorja mbi kërkimin shkencor*⁸⁰ përcakton mënyrën e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitet e organeve kompetente dhe kërkuesve shkencorë, duke përfshirë revistat shkencore, konferencat, projektet kërkimore, publikimet individuale dhe veprat tarinë kërkimore të studentëve, nëpërmjet procedurave që zbatohen në Kolegjin Universitar "Bedér". Studentët gjithashtu inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekteve, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminarë dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Universitetin e Vjenës (Austri), Universitetin e Kairi (Egipt),

⁸⁰ Evidencia nr. 27 Rregullorja mbi projektet kërkimore shkencore



| | Universitetin e Ez'herit (Egipt), etj. ⁸¹ Studentët dhe pedagogët e Departamentit të <i>Shkencave islame</i> kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në programe të ndryshme mobiliteti, të mundësuara nga organizata dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare Personeli akademik vazhdimisht i nxit dhe i mbështet studentët e programit të marrin pjesë në projekte dhe programe të ndryshme për të përfituar sa më shumë jo vetëm në aspektin akademik dhe praktik, por edhe atë social dhe njerëzor. ⁸² | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferencia dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshopë, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+ ose projekteve të tjera. Kolegji Universitar "Beder" dhe programi "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> u kushton shumë rëndësi leksioneve ose seminareve të hapura për studentët. Në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione, seminare ose workshopë të hapura. ⁸³ Të ftuarit në këto orë mund të janë staf i brendshëm ose i jashtëm. Një praktikë shumë e suksesshme në këtë drejtim kanë qenë seritë e seminareve "Kur librat flasin", ku për çdo seancë ftohet një ekspert i fushës dhe diskutohet mbi vepra të ndryshme me qëllimin realizimin sa më mirë të misionit dhe vizionit të departamentit. | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në <i>Rregulloren e programit</i> të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Diplomimi është një proces që rregullohet përmes rregulloreve dhe procedurave të miratuar nga institucion. Ai është pjesë e <i>Rregullores themelore</i> të institucionit, <i>Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i> , <i>Rregulloren e programit</i> , ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përbushë studenti deri në finalizimin e diplomimit të tij ⁸⁴ . Udhëzimi për shkrimin e tezës është publikuar në faqen e institucionit dhe është i aksesueshëm nga të gjithë studentët. |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përbyllëse. | KU "Beder" bën publik informacionin rreth provimeve finale dhe mbrojtjes së diplomave në përputhje me <i>Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë</i> . Këshilltarët akademikë dhe udhëheqësit e diplomave kanë rol kyç në përcjelljen e informacioneve, udhëzimeve dhe materialeve të nevojshme në funksion të detyrimeve përbyllëse. Gjithashtu, krahas <i>Manualit për përgatitjen e punimit të diplomës</i> , gjendet dhe <i>Formulari i vlerësimit të tezës</i> , ku gjenden dhe kriteret e vlerësimit të temës së diplomës për studentët e ciklit të parë. ⁸⁵ |
| Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ | Bërja e një punimi të detyrueshëm të tezës nga ana e studentit, në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një nivel profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, prezantimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i tezës përfshihet si lëndë e semestrit të dytë në programin |

⁸¹ Evidenca nr. 29 Mobiliteti i stafit dhe studentëve

⁸² Evidenca nr. 74 Lista e institucioneve me të cilat KU Beder ka marrëveshje partneriteti përbashkëpunimë në fushat e ndryshme

⁸³ Evidenca nr. 64 Plani i aktivitetave te departamentit

⁸⁴ Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

⁸⁵ Evidenca nr. 66 Formular Vlerësimi i Tezës Bachelor

| | |
|---|--|
| modulet në bazë të rëndësise dhe peshës specifike. | mësimor. Mbrojta e diplomës kryhet në praninë e një komisioni, i cili bën vlerësimin përkatës ⁸⁶ . |
| Kriteri 4. Personeli akademik/udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Këshilltar akademik ⁸⁷ , po ashtu edhe udhëheqësi i diplomës ka rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi. Në fillim të semestrit të dyti, secili student që ka të drejtë të marrë temën e tezës dhe propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtarë të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron ta kryejë atë. Gjatë kësaj periudhe, studentët marrin prej udhëheqësit të gjitha udhëzimet, mbështetjen, orientimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të punës së tyre kërkimore-shkencore. Udhëheqësi akademik siguron cilësinë e punimit të diplomës duke miratuar ose refuzuar dorëzimin e këtij punimi pranë zyrës përkatëse në institucion. |
| Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së tezës është e udhëheqësит. Është pikërisht udhëheqësi ai që ndihmon studentët edhe për nevoja të veçanta që duhen mundësuar nga institucioni, në kuadër të përgatitjes me sukses së tezës. ⁸⁸ Udhëheqësi shkencor ka një rol të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së tezës. Në bazë të vlerësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, roli i udhëheqësит është i mirë përcaktuar. Laboratorët dhe biblioteka janë në dispozicion. Gjatë periudhës së provimeve dhe punimit të tezës ato janë të hapura edhe në fundjavë. |
| Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Studenti në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës, sipas udhëzuesve të miratuar, asistohet nga udhëheqësi i tezës. Në këtë mënyrë ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Udhëheqësi vendos nëse studenti është gati ta paraqesë punën e tij/saj para një komisioni. Në përfundim të punimit dhe mbrojtjes së tezës, studenti vlerësohet me notë. |
| Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS, nuk ka asnjë notë jokaluese dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara sipas rregullores, atëherë pajiset me diplomë bachelor dhe suplementin e diplomës, sipas formave të licencuara dhe të aprovuara nga MAS. ⁸⁹ Studentët mund ta aksesojnë programin e zhvilluar në çdo moment, nëpërmjet sistemit të automatizuar BIS. Në përfundim të studimeve, me kërkesë prej tij, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të studimit të zhvilluar. |
| Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | KUB, pas diplomimit arkivon dokumentacionin e studentit në zyrat e arkivës. ⁹⁰ Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetimë për qëllime të ndryshme, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. ⁹¹ |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |
| | X |

| | |
|--|---|
| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |
| | X |

⁸⁶ Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Shkenca Islame

⁸⁷ Evidenca nr. 49: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik

⁸⁸ Evidenca nr. 73 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

⁸⁹ Evidenca nr. 45 Diplomë bachelor dhe suplementi i diplomës

⁹⁰ Evidenca nr. 59 Rregullorja e Arkivës

⁹¹ Evidenca nr. 26 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore



 Faqja 25

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, përfshirë kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | <p>Titullari i lëndës angazhuar në zhvillimin e programit të studimit "Bachelor" në <i>Shkenca Islame</i> është me grada dhe tituj, sipas kërkesave të legjisacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.⁹² Nga CV-të e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, vihet re se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në programin e studimit zoteron kualifikimin e duhur akademik, në nivelin e kërkuar për mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe kryerje të veprimtarive të tjera mësimore në lëndët e programit. Në procedurën e punësimit të stafit akademik i kushtohet shumë rëndësi përputhjes së profitit të personit që punësohet me kërkesat e programit të studimit në të cilin ai/ajo do të angazhohet.</p> <p>Si personeli akademik me kohë të plotë, po ashtu edhe ai me kohë të pjesshme kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. Stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit kanë grada shkencore dhe tituj akademikë. Fusha kërkimore e stafit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve.</p> |
| Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | <p>Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada shkencore dhe tituj akademikë, sipas kërkesave të legjisacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.⁹³</p> <p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit "Bachelor" në <i>Shkenca Islame</i> në përputhje me kornizën ligjore në fuqi duke mbuluar 75% (për qind) të orëve në auditor.⁹⁴</p> |
| Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | <p>KUB garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar për periudhën e studimit si dhe përgjithë periudhën e akreditimit. Gjatë kësaj periudhe institucioni siguron kontratën e punësimit, mbulimin me siguracionet shoqërore dhe shëndetësore. Institucioni në zyrën e burimeve njerëzore zoteron të gjithë dokumentacionin e plotë të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit Bachelor në <i>Shkenca Islame</i>, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> |
| Kriteri 4. KUB ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përbajtjen e programit të studimit. | <p>KU "Bedër" ndjek procedurat ligjore dhe transparente në rekrutimin e personelit, në përputhje me statutin dhe rregulloren⁹⁵. Personeli akademik, apo ndihmës mësimor-shkencor, por edhe ai administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të KUB. Personeli në institucion dhe konkretisht në Departamentin e <i>Shkenca Islame</i> është përzgjedhur, duke i treguar një rëndësi të veçantë fushës së tyre të specializimit për ta përputhur më së miri me zhvillimin e departamentit dhe të institucionit gjithashtu.</p> |

⁹² Evidenca nr. 16 CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

⁹³ Evidenca nr. 16 CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

⁹⁴ Evidenca nr. 65 Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës

⁹⁵ Evidenca nr. 14 Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik



| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mqediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Departamenti angazhon personel me kualifikim akademik me titullin “asistent - lektorë”, të cilët ndihmojnë titullarët e lëndëve në proceset e tyre akademike. Gjatë orëve të mësimit, në varësi të nevojave specifike, pedagogët ndihmohen nga ky personel. Duhet të theksohet se mësimdhënia në programin "Bachelor" në <i>Shkenca Islame</i> në Departamentin e <i>Shkencave Islame</i> përgjithësisht mbështetet në leksione dhe seminare të integruar me njëra-tjetrën dhe nuk ka orë të mirëfillta laboratorike. | | | | | | | | |
|---|--|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|----------|
| Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me leglacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënavë personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Zyra e <i>Burimeve njerëzore</i> disponon një dosje të posaçme për çdo anëtar të personelit akademik dhe administrativ, të përditësuar sipas kuadrit ligor në fuqi. ⁹⁶ ⁹⁷ Institucioni disponon një bazë të dhëash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit si dhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit "Bachelor" në <i>Shkenca Islame</i> . Çdo fillimsemestri, me propozim të njësiesë bazë, aprovim të dekanatit dhe miratim të rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore ⁹⁸ për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti ⁹⁹ . Shembulli i kësaj procedure mund të vërehet në udhëzimin për <i>Ngarkesën mësimore</i> ¹⁰⁰ . | | | | | | | | |
| Kriteri 7. KUB, në marrëveshje e bashkëpunim me institucionet e tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në disposicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimitari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Angazhimi i personelit aktual akademik synon të arrijë një punë optimale për përbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënieve e mësim nxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucionet e kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. ¹⁰¹ Institucioni dhe departamenti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit dhe/ose organizata fetare të ndryshme, si: medresetë, KMSH, KNFSH, <i>Prizmi</i> etj. ¹⁰² ¹⁰³ Marrëveshjet realizohen nëpërmjet zyrës së <i>Planifikimit të karrierës</i> , me qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të ciklit të parë të studimeve. Gjithashtu, studentët marrin instruktimin dhe mbikëqyrjen e nevojshme në punimin e diplomës. ¹⁰⁴ | | | | | | | | |
| Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Personeli mbikëqyrës në institucionin pritës në bazë të marrëveshjeve angazhohet të asistojë studentët në përbushjen e detyrimeve përfundimtare si dhe plotësimin e raportit përfundimtar. Ai gjithashtu përfshihet në procesin e vlerësimit të praktikës profesionale. ¹⁰⁵ | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #ff9966; color: white;">Nuk përbushet</th> <th style="background-color: #ff9933; color: white;">Përbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #ffff99; color: black;">Përbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #99cc99; color: black;">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

⁹⁶ Evidencia nr. 63 Lista e të dhënavë të dosjes së stafit

⁹⁷ Evidencia nr. 69 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënavë personale

⁹⁸ Evidencia nr. 23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore

⁹⁹ Shih tabelën nr. 7

¹⁰⁰ Evidencia nr. 20 Udhëzim për ngarkesën mësimore

¹⁰¹ Evidencia nr. 60 Raport i Zyrës së Planifikimit të Karrierës

¹⁰² Evidencia nr. 38 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale

¹⁰³ Evidencia nr. 76 Marrëveshja e bashkëpunimit me Medresetë

¹⁰⁴ Evidencia nr. 73 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

¹⁰⁵ Evidencia nr. 41 Rregullorja e Praktikës Profesionale



Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mqedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi | | | | | | | | |
|---|--|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni siguron mqediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Sipas nevojave të programeve akademike, KU "Bedër" ofron mqedise që ndihmojnë studentin në formimin e tij teorik, praktik dhe profesional. Të tillë janë: salla e gjyqit, klinika e ligjit, multimedia lab, laboratori i kompjuterëve, salla e konferencave, biblioteka, salla e lutjeve etj. Duke iu referuar paraqitjes dhe përshkrimit që na ofron tabela për infrastrukturën, KU "Bedër" dëshmon se ka një sasi të mjaftueshme hapësirash, si: laboratorë, klasa, zyra apo mqedise të tjera të cilat janë të pajisura me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve të ciklit të parë. ¹⁰⁶ | | | | | | | | |
| Kriteri 2. Mqediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mqedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Pajisjet e mqediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie, në përputhje me qëllimet e programit. Auditorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjutera, pulte, internet. Të gjitha mqediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe me ndriçim të mjaftueshëm. | | | | | | | | |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mqediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnjë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkeseve të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Programi "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> nuk është i natyrës teknike, për të cilat nevojiten laboratorë eksperimentimi. Megjithatë, universiteti disponon auditorë dhe mqedise mësimore me mjetet e nevojshme, si kompjutera, smartboard, dhe internet, të cilat janë të përshtatshme dhe lehtësojnë plotësimin e kërkeseve të moduleve të lëndëve. | | | | | | | | |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Megjithëse programi "Bachelor" në <i>Shkenca islame</i> nuk i përket natyrës teknologjike, KUB ka ngritur dy laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. ¹⁰⁷ | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

¹⁰⁶ Evidenca nr. 10 Mqediset e Fakultetit / Njësive Bazë (Tabela 16)

¹⁰⁷ Evidenca nr. 10 Mqediset e Fakultetit / Njësive Bazë (Tabela 16)

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digitale) garanton marrjen e dijeve dhe njofurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekën e institucionit të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të librave përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi ¹⁰⁸ . |
| Kriteri 2. Departamenti si njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet ¹⁰⁹ më të reja të viteve të fundit në fushën përkatëse ¹¹⁰ . |
| Kriteri 3. KUB vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka e Kolegit Universitar "Bedër" zotëron titujt kryesorë të librave përfshirë literaturën e domosdoshme të çdo programi ¹¹¹ . Biblioteka është e hapur gjatë gjithë periudhës së aktivitetit universitar, si dhe është e pajisur me vende leximi dhe me kompjuterë duke ofruar kushte të mira dhe të barabarta për të gjithë studentët. |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e KU "Bedër", e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të premte, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 26 000. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU "Bedër", duke mbuluar nevojat e parashikuara sipas këtyre programeve të studimit. |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, KU "Bedër" ka bërë marrëveshje dhe ka akses të plotë si nga ana e studentëve ashtu edhe nga ana e stafit në JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë nëpërmjet emalit të hapur nga domain i KU Bedër, respektivisht shkronja e parë e emrit mbiemwr24@beder.edu.al. ¹¹² |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka e KU "Bedër" është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjuterë për t'u mundësuar studentëve realizimin e detyrate, si dhe mundësi për të pasur akses online në varësi të nevojave të tyre. Po ashtu, databaza e bibliotekës së KU "Bedër" gjendet online, duke i ndihmuar studentët në gjetjen e literaturës. |
| Kriteri 7. Biblioteka e KUB duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit | Oraret e bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë bërë publike në hyrje të bibliotekës. Mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8.30" deri në orën 19.00" të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës. Në funksion të bibliotekës, KU "Bedër" ka vënë në dispozicion edhe |

¹⁰⁸ Evidenca nr. 57 Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

¹⁰⁹ Evidenca nr. 34 Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor

¹¹⁰ Evidenca nr. 77 Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame

¹¹¹ Evidenca nr. 57 Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

¹¹² Evidenca nr. 44 Marrëveshja për akses në JSTOR



| mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online JSTOR - një bibliotekë digitale me punime akademike, libra dhe burime informacioni sipas fushave specifike të studimit. | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar ¹¹³ për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës. Biblioteka siguron raportimin mbi të dhënat e përdorimit të fondit fizik dhe online të bibliotekës si nga stafii ashtu edhe nga studentët e programeve të ndryshme të studimit, titujt kryesor, shfrytëzimi i faciliteve si sallat e studimit si dhe duke bërë edhe një analizë objektive se sa efektive kanë qenë përpjekjet për pasurimin e bibliotekës me tituj qoftë për fondin fizik por edhe atë online. ¹¹⁴ Gjithashtu, departamenti në fillim të vitit akademik pas konsultimit me lektorët dërgon kërkesat për literaturën e nevojshme. ¹¹⁵ | | | | | | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table> | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Sistemi Informativ Bedër BIS është sistemi i automatizimit që përdoret në KU Bedër. Në faqen e menaxhimit të studentëve jepen informacionet kryesore, në lidhje me studentin: ID, emri, mbiemri, programi, emaili, data e regjistrimit, statusi i regjistrimit të lëndëve, transkripti, statusi i komunikimit me bibliotekën etj. Zyra e burimeve njerëzore bën gjithashtu shpërndarjen e orëve dhe emërimin e pedagogëve. Duhet theksuar se ky proces bëhet përpëra hapjes së sistemit të regjistrimit të lëndëve për studentët. Në momentin që është kryer emërimi i pedagogëve dhe është bërë shpërndarja e orëve, atëherë mund të hapet sistemi i regjistrimit të lëndëve. ¹¹⁶ Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. |
| Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin | Sistemi Informativ "Bedër" BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas këtij sistemi të gjitha njësítë kanë një llogari, faqen e tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Në BIS ka një llogari për secilën nga njësítë e mëposhtme: Llogari për studentët, për stafin akademik, burimet njerëzore, sekretarinë e studentëve, bibliotekën, koordinatorët e departamenteve, financën, menaxhimin e dokumenteve, zyrën e pranimit, zyrën e programit të shkëmbimit etj. Nga ana tjetër, |

¹¹³ Evidencia nr. 77 Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame

¹¹⁴ Evidencia nr. 57 Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës

¹¹⁵ Evidencia nr. 77 Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame

¹¹⁶ Evidencia nr. 35 Udhëzues i sistemit informativ BIS




Faqja 30




| | |
|--|---|
| e programit "Bachelor" në Shkencen Islam. | i gjithë dokumentacioni që lidhet me procesin e mësimdhënies, dorëzohen pranë sekretarive të departamenteve. |
| Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron mundshmëri të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi Informativ Bedër BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas këtij sistemi, të gjitha njësitet kanë një llogari, faqen e tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Ky sistem, ofrohet me llogari për studentët dhe me llogari për personelin akademik dhe administrativ. Nëpërmjet sistemit u sigurohet mundshmëri në të dhëna dhe informacione. Po ashtu, një pjesë e informacioneve dhe dokumenteve mund të merren pranë sekretarive. ^{117 118} |
| Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Sistemi i automatizuar BIS, gjithashtu mundëson qarkullimin në kohë reale dhe sinkronizimin e të dhënavëve, si dhe transferimin e tyre nga njëra njësi tek tjetra dhe nga njëra palë e interesuar tek tjetra, me qëllim mbajtjen dhe ofrimin e të dhënavëve të përditësuarë njësive dhe studentëve në çdo kohë. ¹¹⁹ |
| Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi Informativ "Bedër" (BIS) është një sistem që e lehtëson punën në institucionin KU Bedër. I kryen veprimet në një rrugë të automatizuar duke shmangur kështu gabimet e mundshme duke ndjekur të gjitha rregullat dhe procedurat që dalin nga senati ose rektorati. Sistemi BIS u jep mundësinë si studentëve, ashtu edhe lektorëve të monitorojnë në kohë reale pjesëmarrjen në mësim, notën, të dhënat e studentit, etj. |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Në faqen zyrtare në internet të institucionit beder.edu.al gjenden informacionet të cilat lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera të Kolegjit Universitar "Bedër" që publikohen në faqen e internetit në dy gjuhë: njëra është gjuha shqipe dhe tjetra në gjuhën angleze. Në këtë faqe publikohen edhe informacione të dedikuara njësive kryesore e atyre bazë. Informacionet që lidhen me Departamentin e Shkencave Islame gjenden në adresën www.isc.beder.edu.al |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |
| | X |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport finanziar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme përmbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Çdo vit fondacioni harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. Në raport paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të gjitha të detajuara sipas llojit. KU "Bedër" gjeson statusin e institucionit të lartë joftimprurës. Një mbështetje e madhe për institucionin janë donacionet. Institucioni siguron që të ketë të ardhura të mjaftueshme përmbarëvajtjen e programeve të studimit. ¹²⁰ |
| Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e | Në Raportin finanziar të institucionit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të |

¹¹⁷Evidencia nr. 43 Guida e Studentit

¹¹⁸Evidencia nr. 42 Guida e stafit

¹¹⁹Evidencia nr. 82 Të dhëna të plota për platformën on-line. Struktura e teknologjisë së informacionit biblioteka/biblioteka online etj., (Tabela 17)

¹²⁰Evidencia nr. 83 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18).

Faqja 31



| | |
|---|--|
| studimit duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituar dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjera. | tyre. Brenda raportit janë të specifikuara të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte. Në rapport paraqiten të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të grandeve të huaja të përfituar dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve. |
| Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financier të tij. | Çdo vit fondacioni harton një raport të situatës financiare nga një kontabilist i miratuar dhe ky raport ruhet pranë fondacionit. |
| Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Raportet financiare hartohen sipas legjisacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është KU "Bedër", brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të ardhurave dhe shpenzimeve. KU "Bedër" i paraqet çdo fundviti akademik Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) <i>Raportin vjetor institucional</i> , ¹²¹ ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik, si edhe projektbuxheti afatmesëm. |
| Kriteri 5. KUB garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetin financiar të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërryrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | KU "Bedër" gjëzon statusin e institucionit të lartë arsimor joftimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e deri më sot, KU "Bedër" dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU Bedër bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkua të ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL", në ligjin nr.8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat joftimprurëse", në ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre. |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet Përbushet pjesërisht Përbushet kryesisht Përbushet plotësisht |
| | <input type="checkbox"/> |

| Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
|---|----------------------|-----------------------------|----------------------------|-------------------------------------|
| | | | | <input checked="" type="checkbox"/> |

¹²¹ Evidencia nr. 37 Raporti vjetor i KU Bedër, viti akademik 2022-2023

Faqja 32



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi |
|--|--|
| Kriteri 1. KUB harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. ¹²² | Procesi i pranimit të studentëve të rinj në programet e ciklit të dytë që ofrohen nga KU Bedër bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". ^{122 123} Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme, institucioni mbulon ciklin e plotë akademik nga hyrja në dalje duke zbatuar politika dhe procedurat përkatëse. ¹²⁴ |
| Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjtë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Kriteret e pranimit për studentët e rinj bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit dhe gjithashtu në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi edhe në portalin U-Albania. Nga ana tjetër, kriteret e nevojshme për t'u plotësuar nga ana e studentëve me qëllim kalimin e tyre nga njëri vit akademik në tjetrin dhe për diplomim parashikohen dhe janë publike për studentët në <i>Rregulloren themelore</i> dhe në <i>Rregulloren e ciklit të dytë</i> . Institucioni ofron mundësinë për studentët të shfaqin edhe interesin e tyre për të aplikuar pranë KU "Bedër" me anë të një formulari interesimi ne panairet "work and study" dhe kjo mundëson marrjen nga ana e tyre të informacionit paraprak, krahas ndjekjes së procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në portalin <i>U-Albania</i> . |
| Kriteri 3. KUB harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit të ri akademik, kuotat për çdo program studimi të ofruar, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministritë përkatëse (MAS), si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KU "Bedër" mban lidhje të ngushta me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe përmes panaireve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike nxitëse, të gjithë maturantëve të këtyre shkollave u ofrohet mundësia për t'u njohur me ofertën akademike të KU "Bedër". Kriteret e pranimit ¹²⁵ si dhe kuotat e studentëve për çdo program studimi përfshijnë dhe studentët e huaj, të cilët mund të aplikojnë online ose të kontaktojnë me zyrën e <i>Pranimeve</i> për informacione më të hollësishme. ^{126 127} |
| Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit, përgjedhjes dhe përparimit të studentëve përgjatë kursit të studimit, si dhe ato të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësish të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | KU "Bedër", në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me përbajtjen e programeve që ofron. Sa më sipër, njësitë bazë kanë faqet e tyre përkatëse, të cilat mund të aksesohen si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njësive kryesore, siç janë faqet e fakulteteve. Në këto faqe ofrohet gjithë informacioni i duhur, në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, syllabuset e lëndëve, këshillat e departamenteve etj. Po ashtu, procedurat, përgjedhjet e studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare dhe në platforma që administrohen nga KU "Bedër". ¹²⁸ Të gjithë këto informacione mund të ofrohen për studentët e interesuar edhe përmes sekretarive të departamentit dhe sekretarisë mësimore ose pranë zyrës së <i>Pranimit</i> . |

¹²² Evidencia nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegit Universitar Bedër

¹²³ Evidencia nr. 2 Statuti i Kolegit Universitar Bedër

¹²⁴ Evidencia nr. 3 Rregullorja mbi organizimin akademik

¹²⁵ Evidencia nr. 13 Praktika e ndjekur për miratim të kritereve të pranimit të studentëve Bach

¹²⁶ Evidencia nr. 67 Praktika për miratimin e kuotave të pranimit

¹²⁷ Evidencia nr. 55 Kuotat e Pranimit të Studentëve

¹²⁸ Evidencia nr. 25 Rregullorja e transferimit te studimeve

| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkasat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | <p>Si një institucion që i ka të vendosura kriteret e caktuara lidhur me procesin e pranimit të studentëve, KUB varësish politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me kapacitetet, që diktohen me infrastrukturën fizike dhe atë të burimeve njerëzore të cilat zotëron. Përmes kësaj politike, KU "Beder" ka synuar angazhimin maksimal të personelit akademik ndaj studentit, duke respektuar dhe zbatuar të gjitha kriteret e kërkua të këtë aspekt. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panaireve të arsimit dhe karrierës etj.. KU "Beder" bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron, tarifën e studimit si dhe kriteret e pranimit.</p> | | | | | | | | |
|--|---|---------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|----------|
| Kriteri 6. KUB harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret përgjedhjen e kandidatëve me aftesi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. | <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe brenda periudhave të parashikuara nga institucionet përkatëse, KU "Beder" bën publike kuotat si dhe kriteret e pranimit përgjedhjen e studentëve me aftesi të veçanta e ndryshe, por edhe përfshirjen konkrete të studentëve që i përkasin grupeve dhe komuniteteve të pak përfshira apo të marginalizuara. KU "Beder" ka ndërmarrë hapa konkrete përfshirjen e shtresave në nevojë dhe të marginalizuara, përmes bursave të studimit pasqyruar në rregulloren përkatëse. Krahas bursave të ekselencës, të talentit, POSIP etj., KU "Beder" ofron edhe bursa të kategorisë sociale, që përfshijnë studentët me status invalidi, paraplegjiku, tetraplegjiku, etj. https://www.beder.edu.al/sh/content/default/bursat-e-studimit-6/6/154 </p> | | | | | | | | |
| Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret përgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe brenda periudhave të parashikuara nga institucionet përkatëse, KU "Beder" bën publike kuotat si dhe kriteret e pranimit përgjedhjen e studentëve që nuk janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë. Vlen të përmendet fakti se shumë studentë nga shtete të ndryshme kanë zgjedhur të vijojnë studimet pranë KU "Beder", përfshi dhe në Departamentin e Shkencave islame, program studimi i cili ofrohet në gjuhën angleze dhe shqipe.</p> | | | | | | | | |
